VENDIM
Nr. 123, datë 17.2.2016

PËR DISA SHTESA DHE NDRYSHIME NË VENDIMIN NR. 545, DATË 11.8.2011, TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, "PËR MIRATIMIN E STRUKTURËS DHE TË NIVELEVE TË PAGAVE TË NËPUNËSVE CIVILË/NËPUNËSVE, ZËVENDËSMINISTRIT DHE NËPUNËSVE TË KABINETEVE NË KRYEMINISTRI, APARATET E MINISTRIVE TË LINJËS, ADMINISTRATËN E PRESIDENTIT, KUVENDIT, KOMISIONIT QENDROR TË ZGJEDHJEVE, PROKURORINË E PËRGJITHSHME, DISA INSTITUCIONE TË PAVARURA, INSTITUCIONET NË VARËSI TË KRYEMINISTRIT, INSTITUCIONET NË VARËSI TË MINISTRAVE TË LINJËS DHE ADMINISTRATËN E PREFEKTIT", TË NDRYSHUAR

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të nenit 4/2, të ligjit nr. 10405, datë 24.3.2011, "Për kompetencat për caktimin e pagave dhe të shpërblimeve", të nenit 7, të ligjit nr. 152/2013, "Për nëpunësin civil", të ligjit nr. 9584, datë 17.7.2006, "Për pagat, strukturat dhe shpërblimet e institucioneve të pavarura kushtetuese dhe institucioneve të tjera të pavarura, të krijuara me ligj", dhe të ligjit nr. 147/2015, "Për buxhetin e vitit 2016", me propozimin e ministrit të Shtetit për Inovacionin dhe Administratën Publike dhe të ministrit të Financave, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Në vendimin nr. 545, datë 11.8.2011, të Këshillit të Ministrave, të ndryshuar, bëhen këto shtesa dhe ndryshime:

a) Në pikën 1/3 bëhen shtesat dhe ndryshimi i mëposhtëm:

i) Në shkronjën "a" shtohet emërtesa "Inspektorati Shtetëror Teknik dhe Industrial".

ii) Në shkronjën "b", emërtesa "Inspektorati Qendror Teknik", shfuqizohet.

iii) Në shkronjën "c" shtohet emërtesa "Qendra e Grumbullimit dhe Trajtimit të Kimikateve të Rrezikshme".

b) Në fund të lidhjes nr. 3, që përmendet në pikën 3, shtohet ndarja me këtë përmbajtje:

"Autoriteti i Komunikimeve Elektronike dhe Postare – Inspektor – kategoria III-a.".

c) Në pikën 4/1, pas fjalëve "Teknologji informacioni" shtohen "Informatikë ekonomike".

2. Efektet financiare, që rrjedhin nga zbatimi i përcaktimeve të shkronjës "a", nënndarjet "i", "ii", "iii" dhe "b", të pikës 1, të këtij vendimi, të fillojnë nga data e emërimit të nëpunësve/punonjësve në detyrë dhe, për vitin 2016, të përballohen nga fondet e miratuara për secilin institucion për vitin 2016.

3. Efektet financiare që rrjedhin nga zbatimi i përcaktimit të shkronjës "c", të pikës 1, të këtij vendimi, të fillojnë nga data 1 janar 2016.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Edi Rama